

VENDIM
Nr.540, datë 8.4.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.260, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE
SHKOLLORE, TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 7 të vendimit nr.260, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1.Ministria e Arsimit dhe Shkencës mund të miratojë, për përdorim në shkollat shqiptare, edhe tekste të huaja, të përshtatshme për programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me kusht që çmimet e këtyre teksteve të jenë të përafërta me çmimet e teksteve të përdorura në Shqipëri. Nëse shtëpitë botuese prodhuese nuk angazhohen në prodhimin e këtyre teksteve enkas për Shqipërinë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr lejen e botimit prej tyre dhe organizon konkurrimin publik, për të përzgjedhur shtëpinë botuese, që do t’i prodhojë e shpërndajë këto tekste në shkollat shqiptare, sipas pikave të mësipërme të këtij vendimi. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së teksteve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha